



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 79/12

Datë: 18.06.2012

Në mbështetje të nenit 3 (paragrafi 1), nenit 24, 25, dhe nenit 49 (paragrafi 1,2) të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 1), neni 23, 29, 38 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

V E N D I M

1. Urdhërohet Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative e K.K Gjakovë, që në bazë kërkesës së subjektit [REDACTED] të bëjë korrigjimin e të dhënave personale.
2. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të lajmërohet me shkrim brenda tetë (8) ditëve lidhur me zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të pa anshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave personale.

Kemi konstatuar se subjekti i të dhënave në këtë rast [REDACTED] (në tekstin e mëtejshëm subjekti i të dhënave) ka parashtruar kërkesë të ligjshme për korrigjimin e të dhënave personale të saj. Kjo kërkesë garantohej me dispozitat e neneve 24 dhe 25 të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe me nenet 7, 23, 29, dhe 38 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.

Subjekti i të dhënave fillimisht ka kërkuar nga Drejtoria Komonale për Punë të Përgjithshme të bëjë korrigjimin e datës së lindjes nga viti 1947 në 1948.

Kërkesë kjo e hedhur poshtë nga Drejtoria e lartpërmendur, me ç' rast subjekti i të dhënave me 16.05.2007 është ankuar, ankesa nr. 02,2001/19594 në Kolegjin për Ankesa pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike, me ç' rast Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike si organ i shkallës së dytë, ka abroguar Vendimin e shkallës së parë dhe ka lejuar korrigjimin- përmirësimin e të dhënave personale të subjektit.

Zyra përkatëse, respektivisht Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative të Kuvendit Komunal të Gjakovës nuk e ka respektuar Vendimin e shkallës së dytë. Duke bërë shkelje të dyfishtë, duke mohuar të drejtën e subjektit për përmirësim-korrigjim të të dhënave personale, dhe duke mos zbatuar Vendimin e shkallës së dytë-komisionit për Shqyrtimin e Ankesave pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Mosrespektimi i Vendimit të shkallës dytë, ka risjell subjektin e të dhënave të ankohet prapë. Tani në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave pranë Agjencisë për Regjistrimin Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, me Vendimin nr. 13/011 i datës 14.03.2011, si shkallë e dytë tani lë në fuqi Vendimin e shkallës së parë, respektivisht Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Gjakovës të datës 08.05.2007.

Subjekti me qellim të realizimit të të drejtave të saja të garantuara me ligj, ngre padi ndaj Vendimit në fjalë pranë Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme me Vendimin A576/2011, të datës 31.10.2011, anulon Vendimin i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Vendim ky i cili linte në fuqi Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të K.K Gjakovë, që do të thotë se Vendimi i datës 08.05.2007 është anuluar dhe është kërkuar zbatimi i dispozitave ligjore të nenit 38 të Ligjit për Gjendjen Civile, të bëhet korrigjimi i drejtpërdrejtë nga zyrtari i gjendjes civile në bazë të kërkesës së subjektit.

Udhëheqësi i drejtpërdrejtë në bazë të nenit 23, dhe nenit 29 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, [REDAKTUAR] ka qenë i obliguar që të bëjë zbatimin e Vendimit të Gjykatës Supreme, si Vendim i formës së prerë.

[REDAKTUAR] me datë 23.03.2012 me Lëndën Njoftim nr. 02. 201. 1293, njofton palën lidhur me "REFUZIMIN" e zbatimit të Vendimit të Gjykatës Supreme, respektivisht mohon të drejtën e garantuar me ligj, dhe të vërtetuar nga organi me i Lartë Gjyqësor, me Vendim të formës së prerë të Gjykatës Supreme.

Lënda NJOFTIM, që realisht është bërë refuzim, në tekstin shpjegues nuk përmend asnjë dispozitë ligjore në të cilën është bazuar ky refuzim.

Është mjaft shqetësues fakti që një udhëheqës me peshë i cili në baza ditore bën përpunimin e të dhënave personale, në punën e tij nuk konsultohet me asnjë nga aktet ligjore apo nënligjore të cilët janë në fuqi.

Kemi konstatuar se në mënyrë kronologjike janë shkelur në mënyrë të njëpasnjëshme të drejtat e subjektit, nuk janë respektuar dispozitat ligjore, nuk është respektuar Vendimi i shkallës së dytë, dhe së fundi personi përgjegjës për zbatimin e Vendimit [REDAKTUAR] nuk respekton as Vendimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.



Mbrojtës Kryesor Shtetëror

Mentor Hoxhaj

Vendimi i dërgohet:

- Agjencia e Regjistrimit Civil
- Kryeshefit Ekzekutiv K.K. Gjakovë
- [REDAKTUAR] Udhëheqës i Sektorit-Drejtoria për Punë të Përgjithshme K.K Gjakovë
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Arkivit të Agjencisë